



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 16.07.2025
Numër Protokolli: 4817/2025

A.nr.860/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari -anëtarë, me Flakron Gashi- në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën A.nr.860/2025, të datës 12.05.2025, të parashtruar nga ankuesi A.V, kundër Njoftimit të datës 08.05.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.07.2025 mori:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.860/2025, e datës 12.05.2025 e parashtruar nga ankuesi A.V.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, A.V(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), me datë 12.05.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokolli 3092/2025 nën shenjën A.nr.860/2025, Njoftimit të datës 08.05.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, ndërsa kjo e fundit me datë 26.05.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë lidhur me procedurën në fjalë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën të datës 12.05.2025 të parashtruar nga ankuesi në KPMSHCK; Kopjen e ID-së së ankuesit; Njoftimin e datës 08.05.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; E-mailin e ankuesit të datës 08.05.2025 dërguar nga ankuesi në Këshill; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigje në kërkesë të datës 26.05.2025; Konkursin e datës 25.03.2025; Lista e aplikantëve; Aplikacionin e ankuesit i datës 26.03.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; E-mailin e datës 08.05.2025 dërguar nga M.Gj për ankuesin; Njoftimin e datës 08.05.2025 për listën e shkurt.

Kolegji i Këshillit, pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit në këtë fazë **është e palejuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Agjencia për Ndihmë Juridike Falas/Ministria Drejtësisë, më datë 25.03.2025 ka shpallë konkursin me numër Reference RN00017460, për pozitën *“Udhëheqës i Divizionit për Legjislacion”*, ku afati për aplikim ka qenë nga data 26.03.2025 deri më 24.04.2025, ndërsa nga shkresat e këndës arrihet në konstatimin se edhe ankuesi ka aplikuar në këtë konkurs.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi, nuk e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, pasi që Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, përmes Njoftimit të datës 08.05.2025 i ka refuzuar aplikacionin me arsyetimin se i njëjti nuk kishte përmbushur kërkesat e përcaktuara të konkursit në fjalë bazuar në Rregulloren Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, respektivisht nuk kishte bashkangjitur kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës. Tutje, akti i kontestuar përmbante udhëzimin në mjete juridike apo këshillën juridike, si në vijim: *“Kandidati/ja i pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese kundër aktit përfundimtar të procedurës së rekrutimit në KPMSHCK, në afat prej 30 ditëve.”*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se i është refuzuar aplikacioni në mënyrë të kundërligjshëm për procedurën e rekrutimit sipas konkursit RN00017460 të datës 25.03.2025, pasi që aplikacionin e kam bërë në pajtueshmëri me Ligjin Nr.02/L-037 për Përdorimin e Gjuhëve.

Kolegji i Këshillit lidhur me këtë çështje juridike administrative, sa i përket procedurave të pranimit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses mori për bazë dispozitat e nenit 27 Paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, i cili përcakton se: *“4. E drejta e ankimit në KPMSHCK i njihet edhe çdo kandidateje/i në procedurë pranimi në shërbimin civil”*, si rrjedhojë meqenëse ankuesi konteston procedurën e rekrutimit që ndërlidhet me fazën e verifikimit paraprak, atëherë Kolegji i Këshilli konstaton se mënyra e parashtrimit të ankesës lidhur me procedurat e pranimit në Shërbimin Civil është rregulluar me nenin 44 paragrafi 10 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik i cili përcakton se: *“10. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative.”*, dhe me nenin 17 Rregullore Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit Në Shërbimin Civil, është përcaktuar se: *“Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”*.

Kolegji i Këshillit duke marrë parasysh provat e lëndës si dhe duke ju referuara dispozitave të cekura si me lartë konstaton se ankuesi ankesën e datës 12.05.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil e ka parashtruar para shpalljes së rezultateve përfundimtare, gjegjësisht Kolegji konstaton se meqë procedura e ankimit ndaj procedurës së pranimit është parashikuar sipas dispozitave Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, atëherë ankesa e parashtruar para shpalljes së rezultateve përfundimtare është në kundërshtim me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase refuzimi i aplikacionit të ankuesit nuk nënkupton shpalljen e rezultateve përfundimtare në kuptim të nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, pasi që procedura e rekrutimit në rastin e konkursit ndaj të cilit ankuesi ka parashtruar ankesë ende nuk kishte përfunduar në kuptim të nenit 44 paragrafi 10 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, gjegjësisht të paktën deri me datë 12.05.2025 sipas përgjigjes së dhënë nga Njësia e Burimeve Njerëzore.

Bazuar si me sipër si dhe duke ju referuar provave të lëndës Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit e datës 12.05.2025 e parashtruar ne Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbim Civil, është e pa lejueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative sepse e njëjta është parashtruar në fazat fillestare të procedurës së rekrutimit gjatë të cilave ligji material nuk e ka përcaktuar të drejtën e ankesës në KPMSHCK.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.860/2025, datë 16/07/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.V;
- Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.